



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 30.10.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi - Shqipëri, alokimet e vitit 2016”.
3. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”, i ndryshuar””.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Arben Pëllumbi, Ervin Bushati dhe Roland Xhelilaj.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Reme Lala, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Gazmend Barbullushi - Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme

Daniela Cekani - Drejtoreshë e fondeve IPA në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Erjon Luçi - Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Rovena Beqiraj – Drejtoreshë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Alda Klosi - Drejtoreshë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komsionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit.

Sot në rendin e ditës së punës të këtij komisioni ka dy çështje.

Çështja e parë e rendit të ditës është projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komsionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi-Shqipëri, alokimet e vitit 2016”.

Çështja e dytë e rendit të ditës është projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat” i ndryshuar”, propozim i deputetëve.

Për projektligjin e parë relatore është zonja Evis Kushi.

Për të prezantuar projektligjin ndodhet në Komisionin e Ekonomisë, zoti Erjon Luçi, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, si dhe zoti Gazmend Barbullushi, sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme.

Do të procedojmë me prezantimin nga ju dhe më pas me relatoren e Komsionit.

Urdhëroni, fjala për ju!

Gazmend Barbullushi – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë, në cilësinë e përfaqësuesit të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, si koordinatorë kombëtarë e asistencës së Bashkimit European, sot paraqesim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komsionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi-Shqipëri, për alokimet e vitit 2016”.

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i marrëveshjes tripalëshe të financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Malit të Zi dhe Komsionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar, Mali i Zi-Shqipëri, për alokimet e vitit 2016. Marrëveshja e financimit është miratuar në parim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 798/2017 dhe është nënshkruar për palën shqiptare nga ministri për Europën dhe Punët e Jashtme në dhjetor të vitit 2017. Programi i bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi-

Shqipëri, 2014-2020, është miratuar nga Komisioni Europian, me vendimin zbatues nr.9352/2014.

Për sa u takon alokimeve të programit, për vitin 2016 ato financohen nga një grant i Bashkimit Europian, nëpërmjet instrumentit IPA II, në vlerën 1 milion e 700 mijë euro për të dyja vendet. Kërkohet bashkëfinancim nga të dyja shtetet (sepse e tillë është skema e dhënies së grantit) në shumën 300 mijë euro. Pra, buxheti i përgjithshëm i programit për vitin 2016 arrin vlerën 2 milionë euro.

Për dijeninë tuaj, në total, kontributi që do të japë Bashkimi Europian për zbatimin e përbashkët të programit Mali i Zi- Shqipëri, për përdhën 2014-2020, shkon në vlerën 11 milionë e 900 mijë euro. Për alokime të mëtejshme, palët janë të detyruara të nënshkruajnë marrëveshje të tjera. Ju bëjmë me dije se tashmë dy marrëveshje paraardhëse janë përfunduar mes palëve për të njëjtin program, për alokimet e vitit 2014 dhe 2015, të cilat janë ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr. 31/2016.

Për t'u rikthyer te programi në fjalë, përfitues të tij do të jenë zonat si më poshtë.

Për Malin e Zi përfituese do të jenë: Adrejevica, Berana, Petnica, Plava, Gucia, Rozhaja, Podgorica, Cetina, Danilovgradi, Budva, Bari dhe Ulqini, domethënë 12 qytete apo zona.

Për Shqipërinë përfituese do të jetë qarku Shkodër me bashkinë e Shkodrës, bashkinë e Malësisë së Madhe, bashkinë Fushë Arrëz, bashkinë Pukë, bashkinë e Vaut të Dejës dhe qarkun e Lezhës në bashkitë Lezhë, Kurbin, Mirditë, si dhe bashkinë Tropojë.

Ky program ka si qëllim të kontribuojë në zhvillimin social-ekonomik të zonave ndërkufitare dhe të rrisë bashkëpunimin midis dy vendeve nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta. Promovon shkëmbimin e eksperiencës dhe njohurive mes përfituesve, targeton përmirësimin e politikave publike midis autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale në zonën e tij. Mbulon një territor prej afro 12 mijë kilometrash katrorë dhe një popullsi rreth 750 mijë banorë.

Programi është hartuar duke marrë në konsideratë problematikat në ekonomi dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës së mbulimit të tij.

Fokusohet në këto prioritetet tematike.

1. Nxitjen e turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

2. Mbrojtjen e mjedisit, nxitjen e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimin dhe menaxhimin e rrezikut.

3. Nxitjen e punësimit dhe lëvizjes gjeografike të punonjësve dhe përfshirjes sociale e kulturore përtej kufirit.

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Ky ishte një prezantim i shkurtër i programit për të cilin është hartuar ligji ratifikues, të cilin ne e kemi sjellë sot para jush. Jemi në dispozicionin tuaj për pyetje apo informacione të ndryshme që mund të kërkonit. Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit!

Po, zonja Kushi.

Evis Kushi – Faleminderit, kryetar!

Marrëveshja që po ratifikojmë sot me anë të këtij projektligji është nënshkruar në muajin dhjetor të vitit 2017 dhe synon sigurimin e financimit për alokimet e vitit 2016, në kuadër të programit të veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II ndërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë.

Ky program ka si qëllim të kontribuojë në zhvillimin social-ekonomik të zonave ndërkufitare dhe të rrisë bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta. Programi mbulon një territor rreth 12 mijë kilometra katrorë me një popullsi mbi 749 mijë banorë dhe synon zhvillimin e qëndrueshëm të tij duke i dhënë prioritet fushave të mëposhtme:

1. Nxitjes së turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore.
2. Mbrojtjes së mjedisit, nxitjes së përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimit dhe menaxhimit të rrezikut
3. Nxitjes së punësimit, lëvizjes gjeografike të punonjësve dhe përfshirjes sociale e kulturore përtej kufirit.

Programi do t'ju krijojë mundësi përfituesve të të dyja vendeve për të shkëmbyer përvojat dhe njohuritë. Ai do të mbështetet edhe në përmirësimin e politikave publike midis autoriteteve kontraktore, rajonale dhe lokale në zonat përkatëse. Financimi do të sigurohet nëpërmjet Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit IPA II përmes një granti të Bashkimit European prej 1,7 milionë eurosh për të dyja vendet. Pjesa tjetër e financimit prej 300 mijë eurosh do të sigurohet nga bashkëfinancimi i të dy vendeve.

Pra, buxheti i përgjithshëm i vitin 2016 për këtë program është në vlerën 2 milionë euro për të dyja vendet. Rreth 85 përqind e financimit është grant i Bashkimit European dhe rreth 15%

është bashkëfinancim kombëtar. Shuma e financimit prej 2 milionë eurosh do të përdoret për financimin e projekteve në përputhje me fushat prioritare të programit.

Projektet do të përzgjidhen pas një procesi transparent aplikimi.

Pritshmëritë: vendi ynë do të përfitojë një grant prej 850 mijë eurosh dhe përfituesit do të jenë jo vetëm institucionet buxhetore, por edhe organizatat e shoqatat jofitimprurëse. Programi që parashikohet të financohet nga kjo marrëveshje është pjesë e programit të bashkëpunimit të vendit tonë me Malin e Zi për periudhën 2014 – 2020, i cili parashikon një financim nga Bashkimi European prej 11.9 milionë eurosh. Ky financim detajohet në marrëveshjet specifike, siç është edhe marrëveshja që po ratifikohet me këtë projektligj, marrëveshja e ratifikuar më parë për alokimet e viteve 2014 – 2015, si dhe marrëveshje të tjera që do të ratifikohen në vijim. Përfitues të këtij programi në vendin tonë janë zonat e Shkodrës, Lezhës dhe Tropojës, ndërsa në Malin e Zi janë rreth 12 zona.

Si konkluzion, marrëveshja që parashikohet të ratifikohet me këtë projektligj është mjaft e rëndësishme, pasi do të ndihmojë në përfitimin e grantit nga Bashkimi European për realizimin e një pjese të programit disavjeçar në bashkëpunimin me Malin e Zi. Meqenëse shuma e financimit do të detajohet sipas projekteve, është e nevojshme që strukturat ekzekutive të rrisin mbështetjen ndaj hartuesve dhe propozuesve të projekteve për të mundësuar përthithjen e projekteve më cilësore, zbatimi i të cilave çon në realizimin me sukses të programit.

Mbështetur në këto argumente, i propozoj komisionit miratimin e projektligjit.

Nëse më lejoni, zoti kryetar, kam një pyetje për përfaqësuesit e ministrisë. Ne sot po ratifikojmë një marrëveshje, e cila është nënshkruar në dhjetor të vitit 2017 dhe synon sigurimin e financimit për alokimet e vitit 2016, pra bëhet fjalë për një financim para 3 vjetësh, sepse po hyjmë në vitin 2019, e njëjta gjë ka ndodhur edhe me marrëveshjen që miratuam në vitin 2017, ku bëhej fjalë për fondet e vitit 2015. A mund të na shpjegoni përse është kjo diferencë në kohë?

Faleminderit!

Daniela Cekani – Faleminderit!

Dua të nënvizoj se Komisioni European ka sanksionuar që të gjitha shtetet pjesëmarrëse në një program bashkëpunimi ndërkufitar duhet të lidhin mes tyre marrëveshje 3-vjeçare financimi. Kur i referohemi ratifikimit të projektligjit, siç e vini re i përket një periudhe perspektive financiare 2014 – 2020, ndërkohë që ne çdo vit duhet të miratojmë marrëveshjen vjetore për alokimet e secilit vit. Komisioni European ka një rregull specifik që është rregulli

N+3, i cili nënkupton që pavarësisht programimit në terma perspektive financiare 2014 – 2020, programi shtrihet deri në vitin 2023, pra tri vjet më pas. Prandaj ekziston kjo diferencë, sepse skema është e tillë që alokimet miratohen më vonë se sa miratimi i vetë programit, i cili është miratuar gjatë vitit 2014 dhe më pas ne do të miratojmë hap pas hapi të gjitha alokimet vjetore, duke nisur me dy alokimet e para së bashku të viteve 2014 – 2015 dhe më pas miratohen alokimet e çdo viti përpara hapjes së thirrjes për projektpropozime, pasi çdo vit ne i nënshtrohem të njëjtës skemë për aplikimin për thirrje duke bashkuar edhe alokimet financiare.

Faleminderit!

Erion Braçe – A ka pyetje? Nuk ka. A ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi - Shqipëri, alokimet e vitit 2016”.

Kush është pro në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hedhim në votë projektligjin në tërësi.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, zonja Barbullushi!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 30.10.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”, të ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Arben Pëllumbi, Ervin Bushati dhe Roland Xhelilaj.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Reme Lala, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Erjon Luçi – Zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë

Rovena Beqiraj – Drejtoreshë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Alda Klosi - Drejtoreshë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Erion Braçe – Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, në shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”, nismë e deputetit Petrit Vasili. Dua të bëj disa sqarime lidhur me këtë nismë.

Së pari, siç është bërë e ditur, kjo nismë daton më herët dhe në mënyrë të beftë deputetët propozues, zoti Vasili e të tjerë, ia kanë propozuar Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, madje para se të futej në kalendarin e punimeve të Kuvendit. Pikërisht për këtë arsye Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese mori statusin e komisionit për dhënie mendimi, ndërkohë që Komisioni për Ekonominë dhe Financat ka statusin e komisionit përgjegjës lidhur me nismën. Për shkak se shqyrtimi i kësaj nisme të deputetit në fjalë zgjati tej mase në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, ne kemi pritur vendimmarrjen e këtij komisioni, siç e përcakton edhe Rregullorja e Kuvendit, për të shqyrtuar nismën në fjalë. Për shkak edhe të zgjedhjeve të bëra vitin që shkoi nisma është rifutur në kalendarin e punimeve të Kuvendit. Dje Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese e ka marrë në shqyrtim nismën dhe po në mesditën e ditës së djeshme neve na është paraqitur raporti i këtij komisioni lidhur me nismën. Pikërisht dje kemi vënë në dijeni iniciatorin e nismës që sot do të zhvillohej një mbledhje në Komisionin të Ekonomisë, për të marrë në shqyrtim pikërisht këtë nismë, që në këtë komision, për shkak të zgjedhjes së vetë iniciatorit të këtij projektligji, ishte përjashtuar dhe nuk ishte prezantuar. Pra, sot në këtë komision do të bëhej prezantimi, natyrisht edhe diskutimi i kësaj nisme.

Për fat të keq, ne sot kemi marrë përgjigjen që zoti Vasili nuk është i disponueshëm për të marrë pjesë në këtë komision. Ky është fakt, kurse të tjerat që shkruhen në imail-e janë komente personale të zotit Vasili, të cilit, me shumë modesti, do t’i thosha që t’i marrë mbrapsht për shkak të rrjedhës së ngjarjeve dhe të fakteve, sepse, të them të drejtën, unë kam qenë prezent kur kjo nismë është diskutuar më herët në një tryezë të koalicionit të atëhershëm.

Kështu, unë e falënderoj zotin zëvendësministër që është këtu, por nuk kemi asnjë lloj ngutje për të pritur zotin Vasili nga një vizitë tërësisht ekstraparlamentare jashtë këtij vendi! Me qëllim që të dëgjojmë zotin Vasili lidhur me prezantimin e kësaj nisme, natyrisht të japim edhe opinionet tona, do të kërkoja që gjatë kësaj kohe të mos sulmohet as Kryetari i Kuvendit dhe as ky komision për mosshqyrtimin e kësaj nisme.

Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Nuk kemi çfarë të bëjmë, sepse ne jemi përpjekur edhe pak minuta më herët që ta sjellim zotin Vasili këtu, por ishte e pamundur, pasi ai ndodhet jashtë vendit. Kështu që do t'ju lutesha që të jeni në gatishmëri që kur ky komision të ketë hapësira në axhendën e tij ta marrë në shqyrtim edhe këtë nismë.

Faleminderit!

Mbledhja mbyllet këtu!

Ndërkohë, ne do të vazhdojmë me mbledhjen tjetër.

MBYLLET MBLEDHJA